

KREJT SHOKËT E MI (pjesa 9)

SHËRIM NGA FYERJET

Është faktike që njerëzit lëndojnë njëri-tjetrin. Me qëllim ose pa qëllim ne e lëndojmë njëri-tjetrin. Ti do të lëndosh të tjerët, të tjerë do të të lëndojnë ty. Por mënyra sesi e përballon atë lëndim, ka për të përcatuar në një masë të madhe lumturinë në jetë. Nëse nuk reagon si duhet ndaj një fyerje ajo kthehet në lëndim. Nëse kapesh pas një fyerje që të bëhet, ajo kthehet në lëndim. Nëse kapesh pas një lëndimi, ai kthehet në urrejtje. Lëndimi është një shkatërrues i madh i marrëdhënieve, miqësive. Shumë njerëz thonë, *“Unë nuk e dua më atë njeri, prindërit e mi, shokët e mi, burrin, gruan, nuk ndjej më për ta. Më është ngurtësuar zemra për ta. S’*

e di se çfarë më ka ndodhur.”

Ajo që po ndodh është lëndimi. Lëndimi të harxhon energji aq shumë saqë rrjedhimisht ti boshatisesh dhe nuk ke më se çfarë t’i japësh dikujt.

Bibla thotë,

1 Korintasve 13:5 *“Dashuria nuk dyshon për keq.”*

Një përkthim tjetër thotë, *“dashuria. . . nuk i ruan gabimet.”*

Nuk i mban shënim, nuk i llogarit, nuk dyshon për keq.

Sot dua që të shikojmë një burrë në Bibël që quhet Job i cili kishte çdo mundësi për t’u lënduar dhe për t’u hidhëruar. Ai në kohën e tij mund të ishte, njeriu më i pasur. Dhe brenda një dite humbi çdo gjë që kishte. Kapitulloi. Të gjithë fëmijët e tij iu vranë. Gruaja iu kthye kundra. I ra një sëmundje e pashërueshme e cila të jepte shumë dhembje dhe shokët i erdhën për vizitë dhe në vend që ta ngushëllonin, i thanë, *“Ti e ke fajin.”* Pa pikë ngushëllimi. Ai kishte çdo mundësi që ekzistonte për t’u lënduar, për t’u hidhëruar. Por ai nuk e lejoi lëndimin ta dëmtonte, por e kaloi, u shërua dhe Bibla thotë që pasi e kaloi këtë kohë Perëndia e bëri jetën e Jobit më të madhe, më të bekuar sesa e para. Pavarësisht nga lëndimi që ke patur ti në të kaluarën, Perëndia mund ta bëjë pjesën e mbetur të jetës tënde më të mirë, nëse ti do të reagosh si Jobi.

1. SHKAQET E LËNDIMIT

Tre gjëra që e shkaktojnë lëndimin para se të themi tre mënyrat e shërimit:

1. Lëndohemi nga ajo që thonë njerëzit për ne. *“Ti nuk ke probleme, por ti tallesh me mua; po godet një njeri që është gati në të rënë.”* A mundën fjalët t’i lëndojnë njerëzit? Sigurisht. *“Kjo nuk është e vërtetë.”* Mund të të jap 1 minutë kohë, dhe ti mund të kujtosh diçka që të ka thënë dikush në klasë të parë

që ende të lëndon. Është e mahnitshme se si i mbajmë mend akoma. Na lëndon edhe sot. Ndihe mi të fyer.

2. Çfarë mendojnë njerëzit për ne. *"Ti mendon se je më i mirë se unë dhe i konsideron problemet e mia si provë të fajit tim."* A mund të lëndohesh pa të thënë askush asgjë? Sigurisht. Je ndërë ndonjëherë i refuzuar kur nuk është thënë asgjë? Sigurisht. Vetëm nga mënyra se si njerëzit të shikojnë, nga gjuha e tyre e trupit, nga mesazhet jo verbale, pa fjalë. Ti mund t'i lëndosh njerëzit thjesht duke i injoruar ata, kur bën sikur ata s'ekzistojnë. Disa prej jush mund të keni patur prindër që, sado që përpiqeshit, thjesht nuk mund t'i kënaqnit ata. Dhe kjo dhemb.

3. Çfarë na bëjnë njerëzit. *"Ata që dua më shumë janë kthyer kundër meje."* Tragjedia sot është se abuzimi është në rritje. Abuzimi fizik, abuzimi emocional, abuzimi shpirtëror. Jemi në një shoqëri shumë abuzive. Vini re se Jobi thotë: *"Ata që dua më shumë."* Vendi numër një që shfaqet fyerja nuk është në punë, është në shtëpi. Në martesë, në familje. Sa më të afërt të jenë njerëzit me ju, aq më e madhe është mundësia që ata t'ju lëndojnë. Ata mund t'ju tradhtojnë, të jenë të pabesë, të thonë gjëra që të lëndojnë dhe të bëjnë gjëra që të lëndojnë. Ne duhet të përballemi më shumë me fyerjen në shtëpitë tona -- atë që njerëzit thonë, mendojnë dhe bëjnë për ne.

2. PROBLEMI ME FYERJEN

Kur njerëzit na lëndojnë, mënyra normale për të reaguar është të fyemi. Ky është reagimi i natyrshëm, normal. Nuk është reagimi i duhur. Bën më shumë dëm sesa mirë. Në librin e Jobit thuhet se na bën tre gjëra:

1. Fyerja është e paarsyeshme.

Nuk ka kuptim; është e palogjikshme, irracionale. Nuk ia vlen mundimi.

Jobi 5:2 *"Zemërimi në fakt e vret të pamendin dhe zilia e vret budallanë."*

Ai thotë se nuk ka vlerë.

Ekl. 7:9 *"Mos u nxito në frymën tënd të zemërohesh (të mbash mëri), sepse zemërimi gjen strehë në gji të budallenjve."*

Nuk ka kuptim. Pse? Nuk mund ta ndryshosh të shkuarën. Pavarësisht se sa shumë ke inat, je fyer për atë që ndodhi, nuk do të ndryshojë të shkuarën. Nuk do ta korrigjojë problemin në të tashmen, pavarësisht se sa shumë je fyer. Nuk të bën të ndihesh më mirë. Pra, pse të fyesh? Nuk funksionon. Është marrëzi dhe e pakuptimtë. A ke bërë ndonjëherë ndonjë budallallëk ose marrëzi sepse ke qenë i inatosur? "Do t'ia tregoj unë qejfin!" dhe ti shkon dhe bën diçka vërtetë të çmendur dhe bën një budallallëk.

Shumë herë ne jemi kaq të hidhëruar dhe të fyer, saqë themi gjëra pa menduar as se çfarë po themi.

2. Fyerja është e padobishme.

Shkaktohet nga vetë ne. Jobi thotë: *"Ti vetëm po e lëndon veten me zemërimin tënd!"* Kur zemërohesh, ndihesh i fyer, gjithmonë je ti më shumë i lënduar sesa personi nga i cili je fyer. Ai mund të mos ta dijë fare se çfarë po ndodh. Fyerja gjithmonë të lëndon ty më shumë se këdo tjetër. Ndërsa ti je duke plasur nga inati dhe mërzia, ata po vazhdojnë jetën e tyre. Disa prej jush po lejojnë njerëz nga e kaluara juaj -- një ish-bashkëshort, një prind, një mësues -- që ju kanë fyer atëherë, të vazhdojnë t'ju fyejnë tani. Është budallallëk! Ata nuk mund t'ju lëndojnë më nëse nuk vendosni t'i lejoni. Fyerja nuk është vetëm e paarsyeshme dhe e padobishme, por nuk ia vlen fare. Është një vetëvrasje emocionale. Dikush ka thënë: *"Inati, fyerja është ferr në zemër."* Njerëzit më të mjerë që njoh janë njerëz plot inat. Ata janë të pakënaqur. Thjesht e zgjasin dhimbjen. Kushton shumë.

3. Inati është i pashëndetshëm.

Jobi 21:23-25 *"Dikush vdes kur ka plot fuqi, i qetë dhe i sigurt; ka kovat plot me qumësht dhe palca e kockave të tij është e freskët. Një tjetër përkundrazi vdes me shpirt të hidhëruar, pa pasë shijuar kurrë të mirën."* Ti nuk mund të jesh i fyer dhe i lumtur në të njëjtën kohë. Nëse mban mëri, je kapur pas lëndimit. Dhe është e pashëndetshme. Njerëzit thonë: *"Kujdes me ushqimin, çfarë ha."* Jo ajo që ha, por ajo që të ha ty nga brenda bën një ndryshim më të madh në jetën tënde. Ekziston një marrëdhënie e fortë midis shëndetit tënd fizik dhe shëndetit tënd shpirtëror, midis përbërjes tënde emocionale dhe përbërjes tënde fizike. Ekziston një lidhje midis mëkatit dhe sëmundjes. Nuk po them se të gjitha sëmundjet shkaktohen nga mëkati. Nuk është kështu. Por shumë probleme që po mbart, ia ke sjellë vetes duke mbajtur mëri. Nuk ia ke idenë se çfarë po i bën vetes kur mbahesh pas një lëndimi, një mërie. Gjithmonë të lëndon më shumë ty se këdo tjetër. Shkatërron marrëdhëniet e tua. **Fjalët e Urta 17:22** *"Një zemër e gëzuar është një ilaç i mirë, por një frymë e dërrmuar i than kockat."* Do të të thajë, do të bëhesh sa një grusht nëse e lejon. Për hir të vetvetes, për hir të shëndetit tënd, lëre, fal.

3. SHËRIMI I FYERJES

Unë dua që ne të shohim tre gjërat që Jobi bëri që ia kthyen jetën nga ana tjetër dhe që e bënë pjesën tjetër të jetës së tij më të mirën e jetës së tij, me gjithë dhimbjen e jashtëzakonshme që ai kishte kaluar.

1. Zbulo lëndimin tënd.

Pranoje. Ji i singertë. Thuaj të vërtetën. Thuaj, "Më dhemb!"

Jobi 7:11 *"Prandaj nuk do ta mbaj gojën të mbyllur do të flas në ankthin e frymës time; do të ankohe në hidhërimin e shpirtit tim."*

Duhet ta nxjerr!

Jobi 10:1 "Do t'i them Perëndisë: "Mos më dëno! Bëmë të ditur pse grindesh me mua."

Jobi vjell emocionalisht. "Zot, nuk më pëlqen! Nuk është e drejtë! Jam i inatosur! Situata është shumë e keqe!" Ai i thotë Zotit se sa i zemëruar është. Çfarë bëri Zoti? A mendoni se Zoti u befasua? Zoti e dinte që Jobi ishte i mërzhitur që në momentin kur u mërzhit. Ai thjesht donte që Jobi ta pranonte. Fillimi është ta zbulosh lëndimin tënd. Zbulimi i asaj që ti po ndjen është fillimi i shërimit. Kështu fillon procesi i shërimit në jetën tënde. Nëse do të kapërcesh dhimbjen tënde, dhimbjen emocionale, zbulimi i i asaj që ti po ndjen është fillimi i shërimit. Ti duhet ta ndash atë që po ndjen me dikë.

Disa prej jush janë të zemëruar me Zotin për gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën tuaj. Ai e di, ti e di, por nuk do ta pranosh. Pika e fillimit është të thuash, "Zot, unë jam ende i mërzhitur. Unë jam i zemëruar që kjo ndodhi!" Thjesht duhet ta zbulosh, ta thuash atë që ndjen. Zoti nuk do të të lëshojë ndonjë rrufe mbi kokë nëse e bën këtë. Ai tashmë e di se si ndihesh ti. Ti thjesht fillo procesin e shërimit duke e pranuar që ndihesh i fyer.

Javën e shkuar folëm për katër gjëra që mund të bësh me një ndjenjë, një emocion negativ: ta shtypësh, ta shtrydhësh, ta shprehësh -- këto janë të gjitha mënyrat negative për ta bërë atë -- ose ta rrëfesh. Ti e pranon atë para Zotit. Ti ia thua Zotit.

Çfarë është ajo gjëja në jetën tënde që po pretendon se nuk e di, se nuk është aty? Çfarë është ajo gjëja në martesën tënde që po pretendon se nuk është aty, por në fakt është aty dhe të shqetëson? Dhe dhemb. Çfarë ka te ajo marrëdhënia me të dashurin, të dashurën, shefin, prindërit apo fëmijët... që ti e di se është aty, të gjithë e dinë, por ti po bën sikur nuk është aty? Çfarë ka në familjen tënde që po pretendon se nuk është e vërtetë? Ti duhet të përballësh me të. Ky është hapi i parë.

Disa njerëz thonë, "Do të doja t'i mbyllja derën të shkuarës." Ti duhet, që të mund të vazhdosh në të tashmen. Nuk ka rëndësi se ku ke qenë, aq shumë sa ka rëndësi se cili është drejtimi i këmbëve të tua sot. Ti duhet të mbyllësh derën e së shkuarës, por mundesh pa e zbuluar, pa e thënë më parë. Nuk mund t'ia mbyll derën të shkuarës time derisa fillimisht ta kem përballur dhe ta pranoj, ta ndaj me dikë.

Dikush thotë: "Unë vazhdoj të përpiqem të varros të kaluarën time." Por ajo vazhdon të ringjallet sepse është një varrim i gjallë. Ti nuk je marrë me të. Ajo vazhdon të shfaqet përsëri. Çdo shkas që nxit atë kujtesë e kthen lëndimin. Ti duhet së pari të merresh me të.

Ti duhet të shkosh në shtëpi dhe t'i shkruash një letër Zotit. "Zot, kjo është mënyra se si ndihem për ato gjëra që më lëndojnë. Ku ishe kur ndodhën këto gjëra? Pse më ndodhi mua?" Tregoji Zotit ndjenjat e tua. Ai nuk do të të largojë. Ai të kupton. Mbaj mend: Ai është Ai që të ka krijuar. Ai e di se çfarë ke kaluar. Ku ishte Zoti kur vdiq djali yt? Ai ishte në njëjtin vend ku ishte kur djali i Tij vdiq në kryq. Zoti e kupton dhimbjen. Ne jetojmë në një botë mëkatore ku asgjë nuk është perfekte. Kjo është arsyeja pse ne do të shkojmë në qiell një ditë ku gjithçka do të jetë perfekte. Ne lutemi: "U bëftë vullneti yt në tokë ashtu si në qiell." Kjo është ajo që ne duam këtu poshtë.

Pastaj fol me një një mik. Gjithkush ka nevojë për të paktën një person të cilit mund t'i thuash gjithçka dhe ai do të të dojë pa kushte.

2. Liroje shkelësin (fajtorin) tënd.

Lëre të shkojë, fale. Ti kurrë nuk do të kesh lehtësim derisa ta bësh këtë. Miqtë e Jobit e lënduan jashtëzakonisht shumë. E tradhëtuan. Ata ishin të pabesë, e kritikuan, e keqkuptuan. Asgjë nuk dhemb më shumë sesa të keqkuptohesh apo të akuzohesh në mënyrë të rreme. Nuk ishte aspak faji i Jobit. Ai ishte i pafajshëm. Ai kishte çdo të drejtë të fyhej. Perëndia bëri një kthesë në jetën e Jobit. Kur e bëri Ai kthesën dhe e largoi nga problemi në një jetë të re? Jo pasi Jobi ishte hakmarrë. Jo pasi ai ishte fyer. Por pasi Jobi i liroi shkelësit e tij. Ai i la të shkojnë. I fali ata. Pastaj Zoti filloi të ishte në gjendje të punonte në jetën e tij. Bibla thotë se ai jo vetëm që i la të shkojnë, por edhe u lut për suksesin e tyre.

Jobi 42:10 *"Mbasi Jobi u lut për miqtë e tij, Zoti e ktheu në gjendjen e mëparshme; kështu Zoti i dha Jobit dyfishin e tërë atyre që kishte zotëruar."* Si dhe kur e bëri Zoti? Pasi Jobi i kishte liruar shkelësit e tij.

Pse është e rëndësishme kjo -- që të liroj shkelësit e mi? Sepse ne shkojmë drejt asaj ku përqendrohemi. Është një ligj i jetës që në çfarëdo që të përqendrohesh, është ajo drejt së cilës lëviz. *"Unë nuk do të jem i fyer...!"* Në çfarë po fokusohesh? Fyerje. *"Babai im ishte aq i keq, sa nuk do të bëhem kurrë si babai im."* Ti je duke u fokusuar në atë që nuk dëshiron. *"Unë kurrë nuk do të jem si nëna ime."* Nëse nuk e lëshon, do të fillosh t'i ngjash. Është një fakt i jetës. Nëse nuk i lironi, do të filloni të ngjani me ata që ju kanë lënduar. Hidhërimi në zemrën tënde i bën gjëra shumë të çuditshme personalitetit tënd. Ne nuk duhet të ecim duke mbajtur mëri. Ti duhet t'i falësh ata që të mund t'i lironi dhe të lirosh veten.

Sa shpesh duhet ta bësh? Pjetri i bëri Jezusit këtë pyetje.

Mateu 18:21-22 "Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: "Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?"

Jezusi i tha: "Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë."

Nëse je duke e llogaritur, nuk është falje. A je duke mbajtur pikë në martesën tënde? "Ti e bërë këtë gabim dhe unë do ta mbaj mend, kështu që kur të bëj unë diçka gabim, mund të them: "E mban mend kur e bërë atë gabimin ..."" Nëse po e bën këtë, nuk po tregon dashuri. Dashuria nuk mban shënime. Nëse po e bën këtë, thjesht po shkatërron martesën tënde. Kjo është gjithçka që po bën! Ai thotë 490 herë. Falja duhet të jetë e vazhdueshme.

Falja është një proces. Bibla thotë se është e vazhdueshme -- ti vazhdon të falësh. Sa herë që shfaqet ai kujtim, ti fal përsëri derisa ta dish se e ke lëshuar. Atëherë nuk ke pse ta bësh më.

Si mund ta di kur e kam lëshuar plotësisht ndjenjën dhe personin? Nuk dhemb më. Ti mund ta kuptosh dhimbjen e tyre. Ti mund të lutesh për suksesin e tyre. Ti mund të ndihesh rehat në praninë e tyre. Bibla thotë: "Lutuni për ata që ju përdorin keq." Ashtu si Jobi. Kur më në fund i liron ata -- kur të ndihesh sikur mund t'i falësh, mund të ndalosh. Nëse nuk ke dëshirë t'i falësh ata, kjo është arsyeja pse duhet ta bësh.

Nuk mendoj se më vjen ndonjëherë të fal dikë. Por e bëj, jo sepse më pëlqen, por sepse është gjëja e duhur për të bërë. E bëj për të çliruar veten, për të përfutur personalisht prej saj. Zoti thotë se është gjëja e duhur dhe së dyti, më bën dobi.

"Nëse i fal, i lë të shkojnë, ata do të lirohen nga faji. Kjo nuk është e drejtë!" ke të drejtë. Nuk është e drejtë. Por kush tha se jeta është e drejtë? Perëndia sigurisht që nuk e ka thënë. Jeta nuk është e drejtë. Shumë njerëz të këqij shpëtojnë, ia hedhin pa u lagur pasi kanë bërë shumë gjëra të liga. Kjo është arsyeja pse unë kam një besim të thellë si në parajsë ashtu edhe në ferr. Nëse nuk beson në ferr, ke një problem të vërtetë. A shpëtojnë njerëzit si Hitleri? Ata vrasin disa miliona njerëz dhe më pas vrasin veten. Pse, kaq është? Zoti nuk është vetëm Perëndia i dashurisë, Ai është Perëndia i drejtësisë. Një ditë Ai do të zgjidhë llogarinë. Bibla thotë se Ai do të kërkojë llogari.

Një ditë do të jap llogari për të gjithë njerëzit që kam lënduar. Prandaj kam nevojë për shpëtim. Kjo është arsyeja pse unë kam nevojë për Jezu Krishtin në jetën time. Prandaj edhe ti ke nevojë për Jezusin. Nuk do t'ia dal kurrë me meritën time. Unë nuk jam mjaftueshëm i mirë. As ti nuk je.

Jeta nuk është e drejtë. Por një ditë Zoti do t'i zgjidhë të gjitha. Zgjidhe ti rezultatin. Sugjerimi im për ty është të bësh atë që Perëndia thotë të bësh. Fale personin dhe lëre Zotin të merret me pjesën tjetër. Kush ka më shumë burime në

dispozicionin e Tij gjithsesi, ti apo Zoti? Kush mund të bëjë një punë më të mirë në të sheshuarit e gjërave, ti apo Zoti? Ndërsa ti je duke pritur që Zoti të japë rezultatin për të të dhënë ty drejtësi, ti i fal ata që të mund të vazhdosh të jetosh, në mënyrë që të jesh i lirë.

Zbulo, thuaj lëndimin tënd është hapi i parë. Liro shkelësit/fajtorët e tu është hapi i dytë.

3. Rifokusoje jetën tënde.

Kështu e shëron atë kujtim të fshehur. Për sa kohë që përqendrohesh te dikush që e ke inat, ai person po të kontrollon. Ti po shqetësohesh për diçka që ai personi tashmë e ka harruar. Jobi bëri tre gjëra për të ripërqendruar jetën e tij: **Jobi 11:13-16** *"Në rast se e përgatit zemrën tënde dhe shtrin ndaj saj duart e tua, në rast se largon padrejtësinë që është në duart e tua dhe nuk lejon që çoroditja të zërë vend në çadrat e tua, atëherë do të mund të lartosh ballin tënd pa njollë, do të jesh i patundur dhe nuk do të kesh frikë, sepse do të harrosh hallet e tua, do t'i kujtosh si uji që ka rrjedhur;"*

Shumë kohë përpara se të vinte psikologjia, Jobi tha se ka tre hapa për shërimin e brendshëm.

1. Fal me zemër. Ky është hapi i parë nëse do të shërohesh emocionalisht nga një lëndim. Kjo do të thotë të bësh gjënë e duhur, atë që Perëndia ka thënë – të lirosh fajtorin. Pavarësisht nëse më pëlqen apo jo, do të bëj gjënë e duhur. Unë i fal, i liroj, nuk do të përpiqem të marr hak. Kështu që unë bëj gjënë e duhur -- ky është hapi i parë. Lëriini të shkojnë dhe falini.

2. Kërko Zotin. Ti duhet të kërkoesh Zotin në jetën tënde. Ftoje Krishtin të hyjë dhe të të mbushë me faljen e Tij. Pse? Unë nuk mendoj se ti mund të krijosh falje të mjaftueshme në jetën tënde për të përballuar të gjitha lëndimet me të cilat do të përballësh, jo vetëm ato të së kaluarës, por edhe ato që do të kesh nga tani dhe deri kur të vdesësh. Do të lëndohesh shumë herë, aq sa nuk mendoj se mund të prodhosh mjaftueshëm falje njerëzore për ta përballuar. Ti ke nevojë për faljen e Zotit në jetën tënde.

Mendo për Corrie Ten Boom, zonjën që fshehu hebrenjtë në banesën e saj për t'i mbrojtur ata nga nazistët. Kur u kapën, jo vetëm hebrenjtë u dërguan në kampet e përqendrimit, por edhe Corrie dhe familja e saj. Të gjithë në familjen e saj u vranë në kampet e përqendrimit, përveç Corrie-s. Ajo duroi torturat dhe abuzimet dhe të gjitha llojet e gjërave. Më vonë ajo u kthye dhe takoi rojet që e kishin abuzuar dhe i fali. Ti nuk mund ta bësh këtë me falje njerëzore. Ti ke nevojë për fuqinë mbinatyrore të Zotit në jetën tënde në mënyrë që ta lësh të shkojë dhe të jesh në gjendje të thuash: "Nuk ishte mirë. Nuk ishte argëtuese.

Ishte keq. Por unë besoj se Zoti mund të nxjerrë edhe të mirën nga e keqja, dhe disi pjesa tjetër e jetës sime do të jetë më e mira e jetës sime."

Kështu që ti e shtrin dorën te Zoti dhe kërkon që Ai të të mbushë me faljen e Tij. Ky është një proces, jo një marrëveshje e vetme. Ti e bën këtë pa pushim ndërsa je shëruar nga këto gjëra.

3. Përballu përsëri me botën. Kur lëndohemi, tundohemi të tërhiqemi, të futemi në një guaskë, të ngremë një mur, "Nuk do të lejoj kurrë një njeri tjetër të më afrohet", "Nuk do të kem kurrë ndonjë marrëdhënie tjetër, "Unë kurrë nuk do të tregoj vërtet se si ndihem në mënyrë që njerëzit të mos të mund të më shfrytëzojnë." Ti vetëm e lëndon veten kur e bën këtë. Thuhet se ti duhet të *"përballesh përsëri me botën"*. Nëse je gjithmonë duke parë atë që të ka ndodhur në të kaluarën, duke e lënë atë të përcaktojë identitetin tënd, është si të ngasësh një makinë duke parë gjithë kohës te pasqyra që tregon rrugën mbrapa. Ti do të përplasësh, do të rrëzohesh. Ti duhet të përballesh me të ardhmen. Vazhdoje jetën. Nuk është aq shumë puna se ku kam qenë, por në çfarë drejtimi janë këmbët e mia tani, sot -- ku po shkoj. Ti duhet të thuash me zë të lartë: "Unë nuk jam më viktimë". Duhet të ndalosh së fokusuari në të kaluarën dhe të shikosh përpara.

"Fal me zemër, kërko Zotin, pastaj përballu me botën përsëri, i vendosur dhe i guximshëm. PASTAJ të gjitha problemet do të zhduken nga kujtesa jote si përmbytje nga e kaluara dhe nuk do të kujtohen më". Atëherë kujtesa do të zbehet dhe dhimbja do të çlirohet. Kjo do të ndodhë. Disa prej jush thonë: "Më duhet të shëroj kujtesën time dhe më pas mund të përballem me të ardhmen". Kjo nuk është ajo që thotë Zoti. Ai thotë se ju bëni këto tre gjëra dhe përballeni me të ardhmen dhe më pas kujtesa do të shërohet. Si? Këtu ka një parim: Nuk mund t'i rezistosh një ndjenje; vetëm mund ta zëvendësosh ndjenjën.

Sa më shumë ta luftosh diçka, aq më shumë e fut atë në jetën tënde. Është një ligj i jetës. Nëse të shtyj dorën tënde, ti do të shtysh dorën time. Kur them "Nuk do të jem i inatosur, i fyer!" gjatë gjithë kohës mendoj për atë që nuk dua. Gjëja kryesore është të ndryshosh kanalet mendore të mendjes sate. Nuk po e largon me forcë nga sytë, thjesht fillon të përqendrohesh në diçka të re.

Në vend që t'i rezistoj lëndimit, unë thjesht e zëvendësoj atë me një drejtim të ri.

Nëse do të bësh këto tre gjëra, mund të shërohesh emocionalisht. Unë vërtet besoj këtë.

Fundi i lumtur i historisë është te

Jobi 42:12a *"Zoti i bekoi vitet e fundit të Jobit më tepër se vitet e para..."* Pjesa tjetër e jetës së Jobit u bë më e mira e jetës së tij. Zoti po të thotë këtë: "Ti ke rëndësi dhe Unë kujdesem për ty dhe pjesa tjetër e jetës tënde mund të jetë më e mira e jetës sate nëse do të heqësh dorë nga ato dhimbje të së kaluarës."

Çfarë kujtimi që të lëndon po zgjedh të mbash akoma? Diçka që tha dikush? Apo bëri? Apo mendoi për ty? Ajo shkakton dhimbje edhe sot. Ndoshta ka ndodhur vite më parë, por kur diçka të aktivizon kujtesën është po aq e dhimbshme sa ishte në atë ditë. Për kë ke thënë: "Unë kurrë nuk do të jem si ai person". Nëse nuk e lëshon, do fillosh t'i ngjash. Fyerja, inati na bën gjëra të çuditshme. Disa prej jush duhet t'i falin prindërit. Të gjithë kemi prindër të papërsosur, por disa prej jush kanë prindër që ju kanë lënduar dhe ju i doni dhe i urreni në të njëjtën kohë. Është e vështirë për një fëmijë të vogël ta kuptojë. Por është e mundur të duash dikë dhe ta urresh në të njëjtën kohë. "Unë e dua babin tim, por pse po e bën këtë?" "Unë e dua mamin tim, por pse e thotë këtë?" Është e vështirë për një fëmijë ta kuptojë.

Disa prej jush duhet të falin një ish të dashur, apo ish-bashkëshort. Ai/ajo ta nxu jetën në të kaluarën; mos lejo që të vazhdojë të ta nxijë akoma. Ai/ajo nuk mund të të lëndojë më nëse nuk mban mëri. Inati nuk ia vlen. Fyerja nuk ia vlen. Është e paarsyeshme, e padobishme, është e pashëndetshme. Për hir të vetes tënde, fale.

"Por unë thjesht nuk mund ta fal!" Kjo është arsyeja pse ke nevojë për Jezu Krishtin. Ti ke nevojë për Të në jetën tënde. Ai mund të sigurojë fuqinë për të falur që askush tjetër nuk mundet. Ai mund ta shërojë atë lëndim që askush tjetër nuk mundet. Hape jetën tënde ndaj Tij. Bëj atë që tha Jobi: "Shtriqe dorën drejt Perëndisë".

Le të lutemi.
Lutja e shpëtimit.